

Data 02.09.2022

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE
DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI: “BLERJE BARNA PER TRAJTIMIN E PACIENTEVE ME MORBUS GAUCHER
E NDARE NE LOTE PER NEVOJAT 12 MUJORE”

FONDI LIMIT: Vlera e pritshme e kontratave që mund të lidhen gjatë Marrëveshjes Kuadër (në total për 3 (tre) lote): prej 337,711,096.80 (treqind e tridhjetë e shtatë milion e shtatëqind e njëmbëdhjetë mijë e nëntëdhjetë e gjashtë pikë tetë) Lekë pa TVSH

REF: REF-40644-09-02-2022

KODI SIPAS FJALORIT TË PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP):

Artikuj Farmaceutike-33680000-0, Produkte Farmaceutike-33600000-6

NDARE NE LOTE:

Nr. Loti:	PRINCIPI AKTIV	FORM/DOZA	PAKETIMI	NJËSIA	Vlerë lekë pa TVSH
LOT 1	TALIGLUCERASE ALFA	Powder for solution for intravenous infusion x 200 units	Box x 1 vial	Flakon/Ampulë	205,821,000.00
LOT 2	VELAGLUCERASE ALFA	Powder for solution for infusion x 400U	Box x 1 vial	Flakon/Ampulë	68,718,339.36
LOT 3	IMIGLUCERASE ALFA	Powder for concentrate for solution for infusion x 400 units/vial	Box x 1 vial	Flakon/Ampulë	63,171,757.44

3.1 Sigurimi i ofertës: (e zbatueshme në rastin e procedurave të prokurimit me një vlerë më të lartë se sa prokurimi me vlerë të vogël).

Në rastin e kontratave sektoriale, enti kontraktor, në bazë të diskrecionit të tij, mund të kërkojë sigurimin e ofertës edhe për procedurat nën kufirin e lartë monetar.

Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Sigurimit të Ofertës, sipas Shtojcës 3.

Shuma e kërkuar e sigurimit të ofertës (në total për të gjitha lotet) është 6,754,221.94 (gjashtë milion e shtatëqind e pesëdhjete e katër mijë e dyqind e njëzet e një pike nëntëdhjetë e katër) Lekë, ku:

Në rastet e paraqitjes së ofertave për Lote të veçanta, vlera e sigurimit të ofertës për secilin Lot do të jetë si më poshtë:

Nr. Loti:	PRINCIPI AKTIV	FORM/DOZA	PAKETIMI	NJËSIA	Sigurimi i Ofertës (2% e FL) në lekë:
LOT 1	TALIGLUCERASE ALFA	Powder for solution for intravenous infusion x 200 units	Box x 1 vial	Flakon/Ampulë	4,116,420.00
LOT 2	VELAGLUCERASE ALFA	Powder for solution for infusion x 400U	Box x 1 vial	Flakon/Ampulë	1,374,366.79
LOT 3	IMIGLUCERASE ALFA	Powder for concentrate for solution for infusion x 400 units/vial	Box x 1 vial	Flakon/Ampulë	1,263,435.15

Shuma e kërkuar e sigurimit të ofertës (në total për të gjitha lotet) i konvertuar ne **euro**, sipas kursit zyrtar te Bankes se Shqiperise date **02.09.2022**, (Lekë për njësi të monedhës së huaj - 117.81) është: **57,331.48 Euro**, i ndare ne lote si me poshte:

Nr. Loti:	PRINCIPI AKTIV	FORM/DOZA	PAKETIMI	NJËSIA	Sigurimi i Ofertës (2% e FL) në lekë:	Sigurimi i Ofertës (2% e FL) në euro:
LOT 1	TALIGLUCERASE ALFA	Powder for solution for intravenous infusion x 200 units	Box x 1 vial	Flakon/Ampulë	4,116,420.00	34,941.17
LOT 2	VELAGLUCERASE ALFA	Powder for solution for infusion x 400U	Box x 1 vial	Flakon/Ampulë	1,374,366.79	11,665.96
LOT 3	IMIGLUCERASE ALFA	Powder for concentrate for solution for infusion x 400 units/vial	Box x 1 vial	Flakon/Ampulë	1,263,435.15	10,724.34

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti kontraktor ***Qendra Spitalore Universitare “Nene Tereza” Tirane*** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

(TE NJEJTA PER TE GJITHA LOTET)

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 29 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“, në të cilën është e parashikuar se:

1. *Oferta ekonomike përmban vlerën ekonomike pa TVSH.*
2. *Operatori ekonomik duhet të hartojë në mënyrë të pavarur, ofertën ekonomike.*

b. Lista e cmimeve të artikujve, sipas Shtojcës 2;

Argumentimi: Kjo shtojcë është pjesë e setit të dokumenteve standarte të tenderit për procedurën e prokurimit të sipërcituar.

c. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;

Argumentimi: Ky kriter u vendos me mbështetje në nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik“, dhe nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“, në të cilën është e përcaktuar se: “1. *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për*

pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”.

d. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ne te cilen eshte e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe ne nenin 30 te VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

- a. Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë Licencën e lëshuar nga QKL ose QKB për tregtim me shumicë të barnave;**

Shënim: Plotësimi i **germës a’ si më sipër nga OE të huaj** është i detyrueshëm vetëm për subjektet që janë të regjistruar dhe ushtrojnë aktivitet në Republikën e Shqipërisë; OE e huaj duhet të deklarojnë që ushtrojnë aktivitetin në fushën e tregtimit me shumicë të barnave, si dhe kur është e mundur, në rastin e shpalljes fitues/renditjes në vend të parë, të paraqesin dokumentacion që vërteton se ushtrojnë aktivitetin e tregtimit me shumicë të barnave);

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Ligjit Nr. 105/2014 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, të ndryshuar, neni 28 “Tregtimi me shumicë të barnave” i cili parashikon qe tregtimi i barnave behet nga subjekte te licensuar:

*” 1. Tregtimi me shumicë të barnave kryhet nga importuesi, eksportuesi, shpërndarësi farmaceutik, që është person juridik ose fizik, tregtar, vendas ose i huaj, **i pajisur me licencën përkatëse për këtë veprimtari, sipas legjislacionit përkatës për licencimin.** 2. Tregtuesi farmaceutik me shumicë mund të tregtojë me shumicë edhe pajisjet mjekësore, sipas përcaktimeve të bëra në legjislacionin përkatës për pajisjet mjekësore” si dhe*

Ligjin nr 10081 date 23.02.2009 (i ndryshuar) “Per licensat, autorizimet dhe lejet ne RSH”.

(shënim - përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse të furnizimit, ose nëse është rasti të prodhimit të mallrave objekt prokurimi, që lidhet me objektin e kontratës së prokuruar).

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për prodhimin dhe/ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- a. Vërtetim nga Dega e Tatimeve për xhiron vjetore të realizuar gjate 3 (tre) viteve te fundit financiare (2019, 2020 dhe 2021) ku vlera mesatare e tyre te jete **jo me e vogel se 40 % e vlerës së fondit limit* të lotit apo shumës së loteve për të cilat konkurron operatori ekonomik.**

*Shënim**: Për efekt të përlogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, vlera mesatare do te aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar sipas sasive të pritshme të lotit/loteve për të cilin ofertohet, konkretisht mbi vlerat e kolonës “Vlera e pritshme e kontratave” ne piken 2.10 /ose/ 2.14

Kur konkurohet për më shumë se 1 lot, vlera mesatare do te aplikohet mbi shumën totale të vlerës së pritshme të kontratave për lotet që konkurrohet.

Nëse operatorët ekonomikë, për lotin/lotet që konkurrojnë, arrijnë vlerën e xhiros minimale të kërkuar në këto DT, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur.

Argumentimi: Ky kriter, eshte vendosur ne perputhje me piken 3 te nenit 77 te Ligjit nr 162/2020, "Per Prokurimin Publik" i ndryshuar, ne te cilin gjejme te percaktuar se: 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.; ne piken 1 dhe piken 2/a te nenit 43 te VKM nr. 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", ku percaktohet se: Pika 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rasteve të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Pika 2/a: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar; Vendosja e këtij kriteri behet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine ekonomike dhe financiare te OE ofertues, duke vertetuar nepermjet dokumenteve te kerkuara me poshte, se zoterojne kapacitet ekonomik dhe financiar per te permbushur kontraten sic eshte parashikuar nga AK.

Legjislatori në ne piken 1 dhe piken 2/a te nenit 43 te VKM nr. 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", ka parashikuar marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet në Procedurën e Hapur, ku percaktohet; Pika 2/a: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar; Referuar ne vleren e fondit limit te kesaj procedure AK ka menduar se vendosja e nje vlere minimale te xhiros jo me e vogel se **20% e vlerës së fondit limit* të lotit apo shumës së loteve për të cilat konkurron operatori,**

është një deshmi e mjaftueshme për të krijuar bindjen tek Autoriteti Kontraktor se Operatorët Ekonomike ofertues zoterojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga AK.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM 285/2021 'Mbi Rregullat e Prokurimit Publik' ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare;* si dhe nenin 13 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 'Për Tatimin Mbi të Ardhurat' i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave; *(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Bazuar në nenin 43 pika 2/a, 43 pika 3 dhe 43 pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", te ndryshuar, ku përcaktohet:

Neni 43 pika 2/a

Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

b) dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar.

Neni 43 pika 3

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Neni 43 pika 5

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale, llogaritet mbi bazën e vlerës maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 29, te Ligjit Nr. 8438, dt. 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar, ku përcaktohet: *Çdo tatimpagues për gatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës.*

Vlerësojmë se vërtetimin për xhiron vjetore të certifikuar të vitit 2021, operatorët ekonomikë mund ta disponojnë pas paraqitjes së deklaratës vjetore në organet tatimore, për të cilën kanë afat deri më 31.03.2022.

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

2.3 Kapaciteti teknik:

a) Dëshmi nga operatori ekonomik për furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë sa **20% e vleres së fondit limit dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.**

- Si dëshmi për përvojën e mëparshme me një ent publik, kërkohen **vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës së bashku me kontratën e lidhur ose/dhe fatura tatimore të shitjes**, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm **fatura tatimore të shitjes**, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, **ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.**

Shënim*: Për efekt të përlogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, 20% do të aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar për këtë procedurë prokurimi, **konkretisht mbi vlerat e kolonës “Vlera e pritshme e kontratave” në piken 2.10 / pika 1**

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me piken 4 të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik”, ne te cilin gjejmë te percaktuar se: 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; si dhe me piken 4 të nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ne te cilen eshte e percaktuar se: [...].4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për

përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Vendosja e këtij kriteri behet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë teknike të OE ofertues, nëpërmjet përvojave të duhura, që janë në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës sic është parashikuar nga AK.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 4 të nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën sa **20 %** të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Autoriteti Kontraktor QSU “Nënë Tereza” Tiranë është institucion terciar Shëndetësor Publik Kombëtar në shërbim të shëndetit të popullatës, të cilës i siguron shërbim shëndetësor parandalues, diagnostikues dhe kurues sipas Kushtetutës së Shqipërisë dhe ligjeve të shëndetit publik. Vendosja e këtij kriteri behet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë teknike të OE ofertues, nëpërmjet përvojave të duhura, që janë në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës sic është parashikuar nga AK.

b) Për barnat e autorizuara për tregtim në Republikën e Shqipërisë, duhet të paraqitet dokument lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore (AKBPM) që bari i ofertuar është i pajisur me autorizim për tregtim në Republikën e Shqipërisë ose certifikate regjistrimi e barit për tregtim në RSH, brenda afatit të vlefshmërisë.

- Në rastin e parashikuar në pikën “b” të kriterëve të kapacitetit teknik të DST, kërkohet Autorizim nga MAH (Mbajtësi i Autorizimit të Tregtimit) ose distributori i autorizuar (*ku të provohet/dokumentohet lidhja e këtij të fundit me MAH*) nëpërmjet të cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet të tregtojë barnat e tyre. Autorizimi duhet të jete i vlefshëm për të gjithë periudhën e kërkuar.

Argumentimi: Ky kriter gjen mbështetje në pikën 2 dhe 4, të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, si dhe në pikën 3 të nenit 3, në pikën 1 të nenit 1, në nenin 17/1 dhe në nenin 18 të Ligjit nr.105/2014 “Për Barnat dhe Shërbimin Farmaceutik”. Nga sa më sipër cituam, cmojme

se kerkimi i dokumentit qe parashikohet ne piken b) te kapacitetit teknik eshte ne perputhje me ligjin perkates per barnat.

Ky kriter gjen mbeshtetje ne nenin 11 dhe me nenin 12 te Ligjit nr. 105/2014 “Per Barnat dhe Sherbimin Farmaceutik” i ndryshuar. Duke qene se per barnat e percaktuara tek pika b) e kapaciteti teknik behet fjale per tregtim te barna te autorizuara ne vendin tone, atehere dokumenti shoqerues qe e verteton kete fakt eshte pikerisht Autorizimi per Tregtim nga mbajtesi i MAH (Mbajtesi i Autorzimit per Tregtim).

d) Deklarate e ofertuesit mbi origjinen e mallit (vendi i prodhimit dhe kompaninë prodhuese / MAH) për barin e ofertuar.

Argumentimi: Ky kriter vendoset me qëllim njohjen e origjinës së mallit dhe kompaninë prodhuese/mbajtesin e autorizimit per tregtim për të identifikuar në mënyrë të qartë atë gjatë lëvrimit të tij dhe për të pasur sigurinë që i njëjti mall i ofertuar do të lëvrohet në destinacion ne perputhje me nenin 40, pika 6 dhe 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

dh) Operatori Ekonomik ofertues, duhet të paraqesë Autodeklarate për afatin e skadencës së mallit sipas përcaktimeve në specifikimet teknike të **Shtojces 5**.

Argumentimi: Kriteri i vendosur në germën d) dhe dh) eshte vendosur nga anetari i NjP qe ka specialitet perkatese ne lidhje me kriteret teknike si dhe eshte ne perputhje me nenin 4 pika 38/b, nenin 36 dhe 77 te Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik”. Deklarata mbi origjinen e mallit (kompaninë prodhuese dhe vendi prodhimit) si dhe deklarata per plotësimin e afatit te skadences se mallit të ofruar, eshte kerkuar ne menyre qe me ane te saj do te behet krahasimi i ofertes, barnave që ofertohen nga OE me autorizimin e prodhuesit dhe dokumentacionin teknik që do të paraqitet në SPE.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shtojca 5.

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Nr. Loti:	PRINCIPI AKTIV	FORM/DOZA	PAKETIMI	NJËSIA
LOT 1	TALIGLUCERASE ALFA	Powder for solution for intravenous infusion x 200 units	Box x 1 vial	Flakon/Ampulë
LOT 2	VELAGLUCERASE ALFA	Powder for solution for infusion x 400U	Box x 1 vial	Flakon/Ampulë
LOT 3	IMIGLUCERASE ALFA	Powder for concentrate for solution for infusion x 400 units/vial	Box x 1 vial	Flakon/Ampulë

SPECIFIKIMET TEKNIKE TË PËRGJITHSHME

(TE NJEJTA PER TE GJITHA LOTET)

Specifikimet teknike të përgjithshme për këto barna, janë si më poshtë:

- **Afati i skadencës:** Data e skadencës në ditën e lëvrimit të mallit duhet të jetë jo më pak se 1/2 e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës /ose/ jo më pak se 1 vit nga data e lëvrimit të mallit.
- **Formë –doza, njësia dhe volumi** për secilin bar është detyruese të jetë sipas specifikimeve teknike.
- **Paketimi:** Mbi çdo paketim duhet të jetë shënuar emri i barit, formë - doza, kodi i barit, përqindja dhe përmbajtja, data e prodhimit dhe e skadencës, nr. i serisë, si edhe përveç pullës së kontrollit të barnave të aplikuar në paketimin e jashtëm/kutinë e ambalazhit të tyre, barnat duhet detyrimisht të jenë të vulosura edhe me vulën me mbishkrimin “PËRDORIM SPITALOR - NDALOHET SHITJA”.
- OE te cilet do te jene palë ne Marreveshjet Kuader (MK) te vitit 2022, jane te detyruar te lajmerojne menjehere OQB/AK, ne cdo kohe, pergjate afatit te vlefshmerise se MK, ne rastet kur:
 - Ndryshon statusi i regjistrimit dhe/ose
 - Ndryshon cmimi i miratuar i barit, objekt i ketyre Marreveshjeve Kuader.OQB rast pas rasti, vepron ne perputhje me nenin 127 ose 128 të LPP si dhe nenit 23 te RPPP

Argumentimi per specifikimet teknike jane vendosur ne baze te shkresës nr. 1933/11 prot., “Kërkesë për Hapje Procedure” të Drejtorisë së Shërbimit Farmaceutik pranë QSU “Nënë Tereza”, bashkëlidhur me Relacionin nr. nr. 1933/10 prot., d i përgatitur nga grupi i punës i ngritur me Urdhrin e Brendshëm me nr. **1933/8 (nr. 319) datë 23.08.2022** ‘Për përlogaritjen e nevojave, argumentimin e fondit limit dhe hartimin e specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit me objekt: **“Blerje barna per trajtimin e pacienteve me Morbus Gaucher e ndare ne lote per nevojat 12 mujore”**, sipas sasive dhe formë/dozave të kërkuara nga Shërbimet e QSUNT, si dhe dokumentacionit bashkëlidhur këtij relacioni, delegimit të bërë nga MSHMS me shkresën nr. 198/26 prot., datë 01.12.2021 ‘Kërkesë për orientim’, drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në vijim të korrespondencës së mbajtur me nr. 4256/3 prot., datë 25.11.2021 e administruar me nr. 198/25 prot., datë 26.11.2021 në vijim të kërkesës së QSUNT për marrje masash për furnizim me barin Velaglucerase, ku me shkresën e QSUNT nr. 198/24 prot., datë 10.11.2021, i kemi bërë me dije MSHM Raportin Përfundimtar të KLSH nr. 387/82 prot., datë 28.10.2021 ‘Raport përfundimtar dhe rekomandime për Auditimin financiar dhe përpuethshmërinë’ të ushtruar nga KLSH për periudhën 01.01.2019 deri me 31.03.2021, ku ndër të tjera KLSH ka lënë detyra dhe rekomandime që QSUNT të prokurojë nevojat reale për barnat që trajtojnë sëmundjen gaucher duek përfshirë edhe pacientët të cilët janë aktualisht të patrajtuar, si dhe trajtimin me tjetër alternativë (imiglucerase ose velaglucerase) për pacientët që trajtohen me taliglucerase dhe të cilët kanë shfaqur reaksione.

- Shkresën e MSHMS, nr. 4256/3 prot., datë 25.11.2021 ‘Kthim përgjigje’, e administruar me nr. 198/25 prot., datë 26.11.2021, ndër të tjera referon se: ...plani i masave për zbatimin e rekomandimeve të KLSH i takon Qendrës Spitalore Universitare Nënë Tereza. Po ashtu vlerësimi i nevojave dhe prioritizimi i tyre..;
- Shkresa nr. 724/14 prot., datë 22.12.2020 drejtuar MSHMS ku ii kërkohet marrja e masave urgjente për trajtimin e të sëmurëve me Gaucher, ku i bëhet me dije MSHMS për pacientët e trajtuar me Taliglucerase, Velaglucerase, pacientët e patrajtuar, si dhe informacioni shkresë i përcjellë me shkresën nr. 724/13 prot., datë 16.10.2020 nga Shërbimi i Pediatriisë së Specialiteteve për dy pacientë që trajtohen me Taliglucerase por kanë shfaqur reaksione dhe për të cilët nevojitet ndryshimi i trajtimit (imiglucerase ose velaglucerase);
- Relacioni nr. 233/5 prot., datë 10.05.2021 ‘Relacion bazuar në urdhrin e brendshëm 143/2021 ‘Për ngritjen e grupit të punës për vlerësimin e preparateve të përdorura për trajtimin e sëmundjes Gaucher në QSUNT’” ku grupi i punës i përbërë nga: Prof. Paskal Cullufi, Prof. Jera Kruja, Prof. Ilir Bibolli, Prof., Arben Ivanaj dhe Prof. Leonard Deda, bën vlerësimin e preparateve të përdorura për trajtimin e sëmundjes Gaucher në QSUNT.
- Shkresa e MSHMS nr. 2359 prot., datë 31.05.2022 ‘Delegim për kryerjen e procedurave të prokurimit publik për plotësimin e nevojave për disa barnave të listës së prokuruar nga MSHMS në cilësinë e OQB’, e administruar me nr. 1602 prot., datë 01.06.2022, ku MSHMS delegon zhvillimin e procedurës së prokurimit për plotësimin e nevojave me barnat që trajtojnë sëmundjen Gaucher, barna të cilat nuk përfshihen në listën totale të prokurimit të përqendruar të barnave në MSHMS.

- Shkresën nr. 1933 prot., datë 20.07.2022 ‘Informacion’ drejtuar përfaqësuesve të MAH për barnat që trajtojnë sëmundjen gaucher në RSH, ku evidentohen sasitë në unite në total për pacientët në trajtim si dhe dy pacientët e ri të cilët nuk janë trajtuar më parë [Së bashku me shkresat nr. 1933/1 prot., datë 01.08.2022, nr. 1933/2 prot., datë 09.08.2022 dhe nr. 1933/5 prot., datë 16.08.2022 për të cilat grupi i punës vlerëson se nuk mund të shërbejnë për përlllogaritjen e fondit limit pasi referuar pikës 1 të nenit 37 “**Çmimi i barnave dhe marzhet**” të Ligjit nr. 105/2014 “**Për barnat dhe shërbimin farmaceutik**” ku përcaktohet se: 1. **Çmimi i barnave në treg është i kontrolluar dhe bazohet mbi çmimet CIF të importit**, të deklaruara nga kompanitë mbajtëse të autorizimit të tregtimit dhe mbi bazën e çmimeve të prodhimit për barnat e prodhuara në vend, të deklaruara nga prodhuesi vendas [...]”, si dhe ne perputhje me nenin 4, pika 38/b të Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik”, nenin 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe neneve 20 dhe 49 të Ligjit nr. 105/2014 “Per Barnat dhe Shërbimin Farmaceutik”.

Gjithashtu: Specifikimet teknike janë vendosur në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP:

“38/b) në rast të prokurimit publik të mallrave ose shërbimeve, specifikimi me të cilin përkufizohen karakteristikat e prodhimit ose shërbimit, siç janë niveli i cilësisë, ndikimi mbi mjedisin jetësor dhe ndikimet klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe arritshmëri për persona me aftësi të kufizuar dhe vlerësim të përputhshmërisë, niveli i realizimit, shfrytëzim i prodhimit, siguri ose dimensione, duke i përfshirë edhe kërkesat relevante për produktin në raport me emërtimin me të cilin shitet, terminologjinë, simbolet, testimet dhe metodat për testim, paketimin, shënimin dhe etiketimin, si dhe udhëzime për përdorim, proceset dhe metodat e prodhimit në secilën fazë të jetëgjatësisë së mallrave dhe shërbimeve, si dhe procedura për vlerësim të përputhshmërisë” si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, “për mallrat që do të prokurohen, autoriteti/enti kontraktor parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementëve më të rëndësishëm përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.”

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Shtojca 6

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Nr. Loti:	PRINCIPI AKTIV	FORM/DOZA	PAKETIMI	NJËSIA	SASIA PER 12 MUAJ
LOT 1	TALIGLUCERASE ALFA	Powder for solution for intravenous infusion x 200 units	Box x 1 vial	Flakon/Ampulë	2500
LOT 2	VELAGLUCERASE ALFA	Powder for solution for infusion x 400U	Box x 1 vial	Flakon/Ampulë	400
LOT 3	IMIGLUCERASE ALFA	Powder for concentrate for solution for infusion x 400 units/vial	Box x 1 vial	Flakon/Ampulë	432

Afatet e lëvrimit:

Afatet e lëvrimit:

(I NJEJTE PER TE GJITHA LOTET)

Kontratat do te jepen brenda periudhës: Nga momenti i lidhjes se Marrëveshjes Kuader me OE te shpallur fitues për secilin lot, me afat perfundimtar 12 muaj nga data e nënshkrimit të MK. QSUNT do të lidhë kontratë në bazë të nevojave të saj në çdo 4 mujor. Përrjashtimisht këtij përcaktimi, autoriteti kontraktor mund të lidhin kontratë për çdo nevojë që del e paparashikuar dhe është e domosdoshme në çdo kohë.

Për çdo kontrate të lidhur brenda marrëveshjes kuadër, sipas përcaktimit më sipër, afatet e lëvrimit do te jene si me poshtë:

- 15% e sasisë së barit duhet të lëvrohet brenda 15 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës.
- pjesa e sasisë së mbetur duhet të lëvrohet deri në përfundim të kontratës dhe sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.

Sasia dhe Grafiku i levrimit jane vendosur ne baze te shkresës nr. 1933/11 prot., “Kërkesë për Hapje Procedure” të Drejtorisë së Shërbimit Farmaceutik pranë QSU “Nënë Tereza”, bashkëlidhur me Relacionin nr. nr. 1933/10 prot., d i përgatitur nga grupi i punës i ngritur me Urdhrin e Brendshëm me nr. **1933/8 (nr. 319) datë 23.08.2022** ‘Për përlllogaritjen e nevojave, argumentimin

e fondit limit dhe hartimin e specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit me objekt: **“Blerje barna për trajtimin e pacienteve me Morbus Gaucher e ndare në lote për nevojat 12 mujore”**, sipas sasive dhe formë/dozave të kërkuara nga Shërbimet e QSUNT, si dhe dokumentacionit bashkëlidhur këtij relacioni, delegimit të bërë nga MSHMS me shkresën nr. 198/26 prot., datë 01.12.2021 ‘Kërkesë për orientim’, drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në vijim të korrespondencës së mbajtur me nr. 4256/3 prot., datë 25.11.2021 e administruar me nr. 198/25 prot., datë 26.11.2021 në vijim të kërkesës së QSUNT për marrje masash për furnizim me barin Velaglucerase, ku me shkresën e QSUNT nr. 198/24 prot., datë 10.11.2021, i kemi bërë me dije MSHM Raportin Përfundimtar të KLSH nr. 387/82 prot., datë 28.10.2021 ‘Raport përfundimtar dhe rekomandime për Auditimin financiar dhe përpunshmërinë’ të ushtruar nga KLSH për periudhën 01.01.2019 deri me 31.03.2021, ku ndër të tjera KLSH ka lënë detyra dhe rekomandime që QSUNT të prokurojë nevojat reale për barnat që trajtojnë sëmundjen gaucher duek përfshirë edhe pacientët të cilët janë aktualisht të patrajtuar, si dhe trajtimin me tjetër alternativë (imiglucerase ose velaglucerase) për pacientët që trajtohen me taliglucerase dhe të cilët kanë shfaqur reaksione.

- Shkresën e MSHMS, nr. 4256/3 prot., datë 25.11.2021 ‘Kthim përgjigje’, e administruar me nr. 198/25 prot., datë 26.11.2021, ndër të tjera referon se: ...plani i masave për zbatimin e rekomandimeve të KLSH i takon Qendrës Spitalore Universitare Nënë Tereza. Po ashtu vlerësimi i nevojave dhe prioritizimi i tyre..;
- Shkresa nr. 724/14 prot., datë 22.12.2020 drejtuar MSHMS ku i kërkohet marrja e masave urgjente për trajtimin e të sëmurëve me Gaucher, ku i bëhet me dije MSHMS për pacientët e trajtuar me Taliglucerase, Velaglucerase, pacientët e patrajtuar, si dhe informacioni shkresë i përcjellë me shkresën nr. 724/13 prot., datë 16.10.2020 nga Shërbimi i Pediatriisë së Specialiteteve për dy pacientë që trajtohen me Taliglucerase por kanë shfaqur reaksione dhe për të cilët nevojitet ndryshimi i trajtimit (imiglucerase ose velaglucerase);
- Relacioni nr. 233/5 prot., datë 10.05.2021 ‘Relacion bazuar në urdhrin e brendshëm 143/2021 ‘Për ngritjen e grupit të punës për vlerësimin e preparateve të përdorura për trajtimin e sëmundjes Gaucher në QSUNT’” ku grupi i punës i përbërë nga: Prof. Paskal Cullufi, Prof. Jera Kruja, Prof. Ilir Bibolli, Prof., Arben Ivanaj dhe Prof. Leonard Deda, bën vlerësimin e preparateve të përdorura për trajtimin e sëmundjes Gaucher në QSUNT.
- Shkresa e MSHMS nr. 2359 prot., datë 31.05.2022 ‘Delegim për kryerjen e procedurave të prokurimit publik për plotësimin e nevojave për disa barnave të listës së prokuruar nga MSHMS në cilësinë e OQB’, e administruar me nr. 1602 prot., datë 01.06.2022, ku MSHMS delegon zhvillimin e procedurës së prokurimit për plotësimin e nevojave me barnat që trajtojnë sëmundjen Gaucher, barna të cilat nuk përfshihen në listën totale të prokurimit të përqendruar të barnave në MSHMS.
- Shkresën nr. 1933 prot., datë 20.07.2022 ‘Informacion’ drejtuar përfaqësuesve të MAH për barnat që trajtojnë sëmundjen gaucher në RSH, ku evidentohen sasitë në unite në total për pacientët në trajtim si dhe dy pacientët e ri të cilët nuk janë trajtuar më parë [Së bashku me shkresat nr. 1933/1 prot., datë 01.08.2022, nr. 1933/2 prot., datë 09.08.2022 dhe nr. 1933/5 prot., datë 16.08.2022 për të cilat grupi i punës vlerëson se nuk mund të shërbejnë për përlllogaritjen e fondit limit pasi referuar pikës 1 të nenit 37 **“Çmimi i barnave dhe**

marzhet” të Ligjit nr. 105/2014 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik” ku përcaktohet se: *1. **Cmimi i barnave në treg është i kontrolluar dhe bazohet mbi cmimet CIF të importit**, të deklaruara nga kompanitë mbajtëse të autorizimit të tregtimit dhe mbi bazën e çmimeve të prodhimit për barnat e prodhuara në vend, të deklaruara nga prodhuesi vendas [...]”*, si dhe ne perputhje me nenin 4, pika 38/b të Ligjin nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik”, nenin 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe neneve **20** dhe **49** të Ligjit nr. **105/2014** “Per Barnat dhe Shërbimin Farmaceutik”, sipas sasive dhe formë/dozave të kërkuara nga Shërbimet e QSUNT dhe ne perputhje me **piken 1** të **nenit 40** të **VKM-se Nr. 285, date 19.05.2021** “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ne te cilen gjejmë te percaktuar se: *1. Në procedurat e prokurimit për mallra, autoriteti/enti kontraktor parashikon sasinë e mallrave që do të lëvrojë, si dhe grafikun e lëvritimit të mallrave.*

Shenim për operatorët ekonomik:

Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike¹. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

- Autoriteti/enti kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, do t’i kërkojë ofertuesit fitues nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të kërkuara sipas Shtojcës 8 të DST. Mosparaqitja e dokumentacionit permbushes per keto pika do te jete kusht skualifikimi.
 - Autoriteti Kontraktor mund te beje verifikimin e dokumentacionit ne perputhje me vetedeklarimin e bere gjate fazes se ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit te dorezuar perben kusht skualifikimi.
 - Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.
-

Shënim2:

- Për operatorët ekonomik të huaj në përmbushje të kriterëve të pëcaktuara në DST për sa i përket Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, që kanë të bëjnë me dokumente ligjore që lëshohen nga institucione publike në RSH apo institucione ekuivalente ligjore me to nëpër vënde të tjera, nëse dokumentet e kërkuara ose ekuivalentet me to nuk ekzistojnë sipas dispozitave të ligjit vendas të tij, atëherë duhet të paraqesin vetë deklaratimet e tyre në përmbushje të kriterit të kërkuar. Në deklaratën e paraqitur duhet të deklarojnë institucionin që mbulon fushën e veprimtarisë për të cilën bëhet deklarimi si dhe duhet të bëjnë publik në deklaratë, linkun e ueb-it të institucionit që mbulon fushën e veprimtarisë, në rastin e verifikimit nga KVO.

- Për operatorët ekonomik të huaj, që kanë regjistrim në shtetet anëtare të Konventës së Hagës (5 TETOR 1961), dokumentet e lëshuara duhet të përmbajnë vulën apostile në përputhje me ligjin nr. 9060, date 8.5.2003 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për heqjen e kërkesës për legalizimin e dokumenteve zyrtare të huaja".

- Për operatorët ekonomikë të huaj, që kanë regjistrim në vendet që nuk e kanë ratifikuar Konventën e Hagës, datë 05.10.1961 për "Heqjen e kërkesës për legalizim diplomatik e konsullor të dokumentave zyrtare të huaj", duhet të bëhen legalizimet e ketyre dokumentave në ambasadat, konsullatat ose zyrat respektive nga vendi i origjinës.

Dokumentet e lëshuara nga autoritete publike në juridiksione të tjera, dhe dokumentet e vërtetuara nga një noter publik në juridiksione të tjera duhet të legalizohen sipas Konventës së Hagës për Vulën Apostile, të datës 05.10.1961

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

NJËSIA E PROKURIMIT: